



Pranuar / Dorezuar Punë/Produkt Received/Delivered	03.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	2342/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.24/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca -kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.24/2023 të datës 06.01.2023, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati kundër Vendimit me Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.24/2023 e datës 06.01.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Anullohet Vendimi me Nr.12/2022 i datës 15.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të kthejë ankuesin në pozitën e punës sipas Aktit të Emërimit me numër protokoll 02/679/09 të datës 05.05.2017, më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagave të pa realizuara nga data 25.12.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovë, më datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 87/2023 e regjistruar nën shenjën A.nr.24/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale dhe vërtetim jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës (tutje referuar ATK), ndërsa më datë 18.01.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 87/2023 të datës 06.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 735 të datës 15.12.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore; Shkresën përcjellëse me numër protokoll 11 të datës 10.11.2022; Shkresën përcjellëse me numër protokoll 17 të datës 24.11.2022; Shkresën me titull "Informata shtesë sipas kërkesës së rastit nr.14-22/DSP të datës 25.11.2022; Shkresën përcjellëse për Komisionin Disiplinor me numër protokoll 18 të datës 25.11.2022; Kërkesën për qasje në dokumente zyrtare e datës 20.12.2022 e parashtruar nga përfaqësuesi më autorizim i ankuesit; Autorizimin për përfaqësim të datës 19.12.2022; Kopje e ID-së së ankuesit; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokoll 14 të datës 10.11.2022; Shkresën me titull "Informata në lidhje me rastin nr.14-22/DSP"; Formularin për hapjen e kutive të vërejtjeve dhe sugjerimeve e datës 24.10.2022; Shkresën anonime (pa datë, adres dhe nënshkrim); E-mailin e datës 23.11.2022, 22.11.2022, 21.11.2022 nga T.M për ankuesin; E-mailin e datës 23.11.2022 nga ankuesi për T.M; E-mailin e datës 06.12.2022 nga I.I për ankuesin; E-mailin e datës 06.12.2022 nga ankuesi për I.I; E-mailin e datës 06.12.2022 nga T.M për ankuesin; E-mailin e datës 10.07.2022 nga N.A për ankuesin; E-mailin e datës 10.07.2022 nga ankuesi për H.H; E-mailin e datës 09.07.2022 nga H.H për I.M; Raportin mbi rastin 14-22-DSP të datës 10.11.2022 nga Zyrtar i Lartë për Hetime në Divizionin për Standarde Profesionale; E-mailin e datës 04.11.2019 nga K.B për Standarde Profesionale; Shkresën e datës 04.11.2019 për Zyrën e Standardeve Profesionale në ATK; E-mailin e datës 14.07.2016 nga A.S për Mail ATK; Kërkesën për veprime të kujdesshme gjatë paraqitjes në rrjetet sociale e datës 14.07.2016 për të punësuarit në ATK; E-mailin e datës 15.11.2019 nga A.S për ankuesin; Raportin mbi rastin 32/19-DSP nga Zyrtari i Lartë për Hetime në Divizionin për Standarde Profesionale; Emailin e datës 22.11.2022 nga T.M për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 302/2023 të datës 13.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 467/2023 të datës 18.01.2023; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 12.12.2022; E-mailin e datës 01.12.2022 nga A.S për N.G; Paralajmërim (Qortimit) me shkrim për ankuesin e datës 17.07.2020 dhe 10.07.2020; Emailin e datës 17.07.2020 nga J.D për ankuesin; E-mailin e datës 16.07.2020 nga I.M për ankuesin; Emailin e datës 15.07.2020 nga I.M për N.A; E-mailin e datës 10.07.2020 nga N.A për ankuesin; E-mailin e datës 09.07.2020 nga H.H për I.M; Postimet nga ankuesi

në rrjetet sociale, 30 prill, 05 maj, 15 korrik, 8 gusht, 25 gusht, 27 gusht, 28 gusht, 02 shtator, 04 shtator, 05 shtator, 08 shtator, 09 shtator, 12 gusht, 17 shtator, 12 shtator, 21 shtator, 29 shtator; E-mailin e datës 10.11.2022 nga A.S për N.G; Mesazh telefoni nga A.H; Vendimin me numër protokoll 314 të datës 29.11.2011; Vendimin me Nr. 4/2018 të datës 11.05.2018 për masë disiplinore ndaj ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*,

Nga administrimit i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, gjegjësisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 02/679/09 të datës 05.05.2017 është i emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Drejtor i Drejtorisë Rajonale* në Gjakovë.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës me Vendimin me Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore nga neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 të Komisionit Disiplinor, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar karakterizohet me shkelje të rënda ligjore dhe vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe juridike, duke theksuar se vendimi i Komisionit Disiplinor i kundërshtuar me ankesë është nxjerr në kundërshtim me afatet e përcaktuar me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe së masa e shqiptuar disiplinore ndaj tij nuk është paraparë si masë disiplinore me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Tutje ankuesi pretendon së procedura disiplinore është iniciuar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që ankuesi kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit që të njëjtin ta kthej në vendin e tij të punës si Drejtor i Drejtorisë Rajonale sipas Akt Emërimit me numër protokoll 02/679/09 të datës 05.05.2017, dhe t'i kompensohen të gjitha pagat dhe benificionet nga marrëdhënia e punës nga data 25.12.2022 deri në zbatimin e këtij vendimi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit për shkelje procedurale, gjegjësisht pretendimit së vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar me ligj, Kolegji i Këshillit analizoj aktin e kundërshtuar me ankesë dhe shkresat tjera të lëndës nga të cilat konstatoi se kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit ka filluar sipas raportit me shkrim nën shenjën 14-22-DSP të dorëzuar me datë 10.11.2020 në njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila në ditën e njëjtë (10.11.2022), përmes shkresës përcjellëse me numër protokoll 11 ka përcjellë rastin në komision disiplinor, ndërsa ky i fundit ka nxjerr vendimin e kontestuar me datë 25.12.2022.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimor ju referuar kuadrit ligjor në fuqi, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 48 paragrafi 9 me të cilin përcaktohet se: *Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedurën e*

hollësishme disiplinore, në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht nenit 12 paragrafi 6 me të cilin përcaktohet se: 6. Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore”, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me shkeljet procedurale është i drejtë dhe i bazuar, sepse nga administrimi i provave të lëndës rrjedh se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh, veprim ky në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, janë të rregulluara çështjet e veprimeve procedurale, ku me nenin 3 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar se: procedura administrative është tërësia e renditur sipas ligjit e veprimeve procedurale dhe materiale të njëpasnjëshme të organit publik, që ka për qëllim përgatitjen dhe vendimmarrjen për një veprim konkret administrativ, shqyrtimin e mjeteve juridike administrative, si dhe ekzekutimin e aktit administrativ, ndërsa me nenin 98 po të njëjtit ligj është përcaktuar se: 1. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë, për atë lloj procedure, nga rrjedhë procedura dhe afati për vendosje është rregulluar me akt të veçantë, siç është Rregullorja (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, e cila me nenin 12 paragrafi 6 ka përcaktuar se: *Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore.*

Kolegji i Këshillit thekson faktin së organi publikë që zhvillon procedurën administrative, për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete mund të shtyj afatin për përfundimin e procedurës administrative në pajtim me nenin 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo në dosjes e lëndës të rastit konkret nuk është gjetur asnjë provë që vërteton së organi kompetent, respektivisht Komisioni Disiplinor ka nxjerr vendim për shtyrje të afatit lidhur me përfundimin e procedurës disiplinore, kështu që duke marr parasysh konstatimin si me sipër se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh si dhe konstatimin se organi publikë që ka zhvilluar procedurën disiplinore nuk ka nxjerr akt administrativ për shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurës disiplinore, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit se vendimi i kontestuar është nxjerr jashtë afatit ligjor është i bazuar.

Kolegji i Këshillit rikujton faktin se në frymën e këtij standardi Këshilli kishte vendosur edhe me rasatin e trajtimit të ankesës A.nr.130/2020 të datës 10.03.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Nga të cekurat si me lartë Kolegji i Këshillit konstatoi së akti i kundërshtuar me ankesë, gjegjësisht Vendimi Nr.12/2022 i datës 15.12.2022 i Komisionit Disiplinor është nxjerr si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe si i tillë është akt administrativ i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, për shkak të konstatimit të shkeljeve procedurale, nuk u lëshua ne trajtimin e pretendimeve materiale si në ankesë, rrjedhimisht më qëllim të kthimit të ligjshmërisë, në mbështetjeje të dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për aprovimin e ankesës dhe anulimin e Vendimit Nr.12/2022 të datës 15.12.2022 të Komisionit Disiplinor, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.24/2023.

Avdyl Bektashi

Procesmbajtës

Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

